Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Avdush Bajramaliu, ***Ekspert shqyrtues i jashtëm***	***01.06.2022***	***08.06.2022***	**Nr. i lëndës:** **172/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.05.2022, "**RENER"SHPK.-nga Prishtina**, ka parashtruar ankesë me nr: **172/22**, per aktivitetin e prokurimit te **(AK) – Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.,**lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Mirëmbajtja e sistemit ekzistues dhe implementimi i faturimit mobil ne terren**", me nr. të prokurimit**: KRURGJA-22-3606-1-2-1,**nr.te brendshme: **KRURGJA-22-015-1-2-1,**iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur** lloji i kontratës: **Kontrat publike kornizë-FURNIZIM,** vlera e parashikuar e kontratës: **98 000,00**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se ka pasur nje vendim

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE te OE.Ankues

Njoftimi për kontrate: 27.04.2022
Afati për dorëzimin e ofertës : 20.05.2022 ora 13:00
Afati i korigjuar per dorezim te ofertave 24.05.2022 ora 13.00
Kërkesa për Rishqyrtim 18.05.2022
Vendimi per kerkesn per rishqyrtim 20.05.2022
Ankesa ne OSHP.27.05.2022
Pretendimet ankimore te,Ankuesit "RENER" SHPK.

1. **Neni 7 i LPP-së**
2. **Neni 28 i LPP-së**
3. **Neni 20.4 i RRUOPP**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "**RENER"SHPK .** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja e sistemit ekzistues dhe implementimi i faturimit mobil ne terren"**, me nr.të prokurimit**: KRURGJA-22-3606-1-2-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**

Operatori Ekonomik Rener SH.P.K., ne cilesine e pales se interesuar, sipas nenit 108A, ka dorezuar kerkese per rishqyrtim me daten 18.05.2022 te cilen e gjeni te bashkangjitur ne kete ankese

Operatori Ekonomik Rener SH.P.K., ne cilesine e pales se interesuar, parashtron kerkese per rishqyrtim pasi qe Autoriteti Kontraktues ne kete procedure te prokurimit, ka shkelur dispozitat ligjore sine vijim:

-Nenin 7 te Ligjit per Prokurim Publik ne Republiken e Kosoves,
-Nenin 28 te Ligjit per Prokurim Publik ne Republiken e Kosoves,

-Nenin 20.4 te Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurimin Publik.

Te dhenat faktike qe mbeshtesin supozimet per shkelje te dispozitave ligjore, jane:
Autoriteti Kontraktues (AK), ka shkelur nenin 7 te LPP per faktin se:

Siq; e kemi thene dhe ne kerkesen per rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues (AK), ka iniciuar procedure te prokurimi duke mos i shfaq te gjitha informatat e nevojshme per te dorezuar oferte konkurrente, ne kete menyre AK e ka reduktuar dhe eliminuar konkurrencen ne mes te Operatoreve Ekonomik dhe ka favorizuar nje Operator Ekonomik ose konsulent paraprak te cilet paraprakisht I kane poseduar te gjitha informatat (në menyr jo zyrtare)

AK ne "pergjigjen' e dhene ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim, thote: AK sqaron se aktiviteti i prokurimit ne fjale permban te gjitha informatat e nevojshme se si do te funksionoj sistemi i kerkuar. Ne as nje moment nuk eshte favorizuar ndonje Operator Ekonomik Te gjithe OE i kane pranuar informatat e tenderit ne te njejten kohe, pra ne kohen e publikimit te njoftimit per kontrate. Ju jeni duke aluduar per informata jo te plota, mirepo ne as nje forme nuk keni pretenduar se cilat informata sipas mendimit tuaj jane duke munguar

"Pergjigja" e dhene e Autoriteti Kontraktues per pretendimin tone 1-a, nuk qendron sepse nuk trajton pretendimet tona ne kerkesen per rishqyrtim 1-a, por i jep konotacion tjeter pretendimeve tona. Ne ne kerkesen per rishqyrtim, nuk kemi thene se informatat e derguara, jane derguar vetem te disa Operator Ekonomik dhe askund nuk themi se ka mungese te informatave se si do te funksionoj sistemi. Ne ne kerkesen per rishqyrtim, kemi thene se nuk jane shfaq/shpalos te gjitha informatat e nevojshme per te dorezuar oferte konkurrente. Per te dorezuar nje oferte konkurrente ku kriteri i perzgjedhjes eshte oferta e pergjegjshme me çmimi me te ulet, parakusht eshte pershkrimi i sakte i kerkesave dhe obligimeve per Operatoret Ekonomik. Nese keto nuk jane te qarta dhe te sakta ne dosje te tenderit, atehere pretendojme qe favorizohet nje Operator Ekonomik qe i posedon informatat ne menyre jo zyrtare sepse ai i ka te qarta kerkesat dhe obligimet e parapara ne kete procedure te prokurimit. Ndersa cilat jane ato informata qe nuk jane shfaqur, i kemi thene ne piken 2-b te kerkeses per rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues, ka shkelur nenin 28 te LPP dhe nenin 20.4 te RRUOPP per faktin se:
a). Siç e kemi thene dhe ne kerkesen per rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, ka perpiluar specifikimet teknike te cilat nuk jane ne perputhje me qellimin e prokurimit dhe nuk jane te drejtuara drejt sigurimit te qasjes sa me te mire per te gjithe operatoret e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Specifikimet teknike, duhet te jete te qarta, te sakta dhe precize dhe duhet te mos paraqet kufizime te panevojshme, ne menyre qe te mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet te perkufizohen ne menyre qe mos te krijojne dyshime rreth natyres se mallrave, puneve ose sherbimeve te kerkuara

b). Autoriteti Kontraktues nuk shpalos te gjitha informatat e nevojshme ne lidhje me ERP ekzistues per te cilen kerkon mirembajtjeje 36 Muaj. Kjo shihet qarte edhe ne sqarimet e dates 28.04.2022, ku AK tregon qe nuke posedon kodin burimor per ERP ekzistues te cilen synon ta mirembaje dhe nuk e sqaron se çka do te ndodhe nese ndonje nga kerkeses e Dosjes se Tenderit dhe Njoftimit per Kontrate e cila implikon ndryshime ne aplikacion dhe jo vetem ne bazen e te dhenave nuk mund te realizohet si rezultat qe AK nuk posedon Kodin Burimor. Siç; e dime te gjithe realizimi i ndryshimeve ne aplikacion nuk mund te

realizohet pa posedimin te versionit te fundit te kodit burimor. Kjo kerkese ne menyre direkte favorizon kompanine qe ka zhvilluar kete aplikacion apo ish punetoret e tyre. Per te qene kerkese gjitheperfshirese autoriteti duhet te definoje sakte se cilat nga kerkesat e mirembajtjes implikojne ndryshime ne bazen e te dhenave dhe cilat prej tyre ne aplikacion - kerkesa te cilat duhet te hiqen apo te ofrohet versioni i fundit i kodi burimor
AK ne "pergjigjen' e dhene ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim per piken 2- a,b, thote:
AK ka perpiluar Specifikime Teknike sipas nevojave te kompanise e jo te OE. Pretendimet jane te pa bazuara
Kerkesa eshet ne kunderthenie me vet deklarimin sepse ne njeren ane thote se nuk shpalos te gjitha informatat e nevojshme kurse ne anen tjeter njeh sqarimet e dates 28.04.2022.
Pretendimet tjera se favorizohet kompania qe e ka zhvilluar aplikacionin jane te pa bazuara. AK per disa vite ka pas kontrate mirembajte me nje kompani qe nuk ka zhvilluar aplikacionin

"Pergjigja" e dhene e Autoriteti Kontraktues per pretendimin tone 2-a,b nuk qendron sepse nuk trajton perendimet tona ne kerkesen per rishqyrtim 2-a,b, por i jep konotacion tjeter pretendimeve tona. AK edhe ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim, insiston se baza e te dhenave eshte e hapur, gje e cila nuk mohohet as nga ne. Por, pyetja jone eshte mese e qarte, çka nese nga AK kerkohet ndryshime ne pjesen e aplikacionit (jo ne bazen e te dhenave) dhe me kete rast dihet se AK nuk e posedon kodin burimor. Cilat do te jene hapat e AK qe do te na mundesojne realizimin e kontrates duke ditur qe brenda termave te references nuk i ka specifikuar se ku implikojne ndryshime kerkesat. Rast ilustrativ: Nese kerkohet vendosja e nje fushe shtese tek dritarja e regjistrimit te konsumatorit, ky ndryshim nuk mund te realizohet vetem permes bazes se te dhenave por edhe brenda aplikacionit per te cilin AK nuk e posedon kodin burimor. Arsyetimi i dhene se nuk favorizohet nje Operator Ekonomik pasi qe sistemin qe disa vite e miremban nje kompani tjeter qe nuk e ka zhvilluar sistemin, nuk qendron per faktin se emri i kompanise ka ndryshuar, por stafi jo, stafi nga kompania tjeter qe e ka mirembajtur sistemin ka qene po ai qe e ka zhvilluar

c).Siq e kemi thene dhe ne kerkesen per rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, me daten 16.03.2022, ka iniciuar proceduren e prokurimit per here te dyte per mirembajte te data bazes se kompanise e qe tash po e quan ERP. Kjo procedure eshte anuluar pasi qe per te njejten nuk ka pranuar oferta nga Operatoret Ekonomik. Autoriteti Kontraktura me te kuptuar qe nuk aplikojne Operator Ekonomik, te njejtes ja shton edhe kerkesat per faturim mobil duke qene te bindur se per kete procedure te prokurimit, do te aplikoj vetem kompania e ci/a e ka zhvilluar edhe mirembajtur data bazen ekzistues (ERP). Nje qasje e tille, eshte e ndaluar me LPP.
AK ne "pergjigjen' e dhene ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim per piken 2- c, thote:
Lidhur me pretendimin tuaj ankimor, e qe nuk perkon me aktivitetin e prokurimit per te cilin keni parashkruar kerkese per ri-shqyrtim, duam t'ju sqarojme se aktiviteti i prokurimit me numer KURGJA-221911-2-3-6, dy here radhazi eshte anuluar. Duke u nisur nga fakti se kompania nuk mund te qendroj pa mirembajte te databazes, dhe pasi qe fatmiresisht kemi pasur ne dispozicion fonde te mjaftueshme ne si AK kemi vendosur qe te iniciojme dhe aktivitetin per implementimin e faturimit mobil ne terren. Ne kete menyre e kemi konsideruar si te udhes qe pasi kene natyre te njejte te zhvillojme vetem nje aktivitet te prokurimit, gje per te cilen AK vendos se do i procedoj aktivitetet.
Pergjigjen" e dhene e Autoriteti Kontraktues per pretendimin tone 2-c, nuk qendron sepse nuk trajton perendimet tona ne kerkesen per rishqyrtim 2-c, por i jep konotacion tjeter pretendimeve tona duke thene qe AK nuk mund te qendroj pa mirembajte te data bazes. Ne ne kerkesen per rishqyrtim, nuk kemi thene qe Autoriteti Kontraktues duhet te qendroj pa mirembajtje, por e kemi faktuar qe eshte favorizuar nje Operator Ekonomik edhe e kemi treguar kronologjine. Autoriteti kontraktues e gezon te drejten per menaxhim te ndermarrjes dhe nuk jemi kunder, perkundrazi por nuke gezon te drejten e favorizimit te nje Operatoreve Ekonomik sepse eshte e ndaluar me ligj.
d).Siq kemi then edhe ne kerkesen per ryshqyertim ,Autoriteti kontraktues ka perpiluar specifikime teknike qe favorizojne nje ose me shume Operatore Ekonomik, duke kerkuar licenca, pa e definuar

sasine e as llojin e licencave. Nje kerkese e tille, bene favorizim te nje Operator Ekonomik ose konsulente paraprak te cilet paraprakisht e kane informaten (ne menyre jo zyrtare) se per qfare sasie dhe licenca behet fjale.
AK ne "pergjigjen' e dhene ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim per piken 2- d, thote:
Pretendimi ishte i pa bazuar ne ndonje fakt te qendrueshem. Vet deklarata se favorizohen nje ose me shume OE perben konkurence. Aktiviteti i prokurimit iishte 3 vjeqar dhe nuk mund te percaktojme nevojen pe numrit e licencave ne nje afat te tille.
"Pergjigja" e dhene e Autoriteti Kontraktues per pretendimin tone 2-d, nuk qendron sepse trajton vetem njeren pjese te pretendimet tone dhe vazhdon tutje duke mos e tregon sasine dhe llojin e licencave, kjo na e forcon bindjen edhe me shume se AK po e favorizon nje Operator Ekonomik i cili ne menyre jo zyrtare e ka informaten per sasine dhe llojin e licencave. Po ashtu AK permes kesaj pergjigje tregon qarte se me vetedije te plote eshte duke e shkelur nenin 28 te LPP dhe nenin 20.4, 56.11 te RRUOPP

) Siq e kemi thene dhe ne kerkesen per rishqyrtim, Autoriteti kontraktues, ka perpiluar specifikime teknike qe favorizojne nje Operatore Ekonomik, duke kerkuar qe brenda 30 dite kalendarike te kryhet implementimi/ liferimi per pozicionin 2-9, kerkese kjo qe favorizon vetem Operatorin Ekonomik i cili e posedon sistemin sipas kerkesave te AK dhe posedon ne stok pajisjet harduerike sipas kerkesiis se AK.

AK ne "pergjigjen' e dhene ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim per piken 2- e, thote:

Autoriteti Kontraktues sqaron se nuk eshte bere favorizim i ndonje OE. Eshte kerkuar afati i tillei implementimit, pasi qe konsiderohet mese i mjaftueshem nga AK dhe duke marr parasysh qe eshte kerkuar staf prej 3 inxhiniereve,jane me se te mjaftueshem per perfundimin e projektit ne 30 dite kalendarike, poz 2-9.

Pergjigja" e dhene e Autoriteti Kontraktues per pretendimin tone 2-e, nuk qendron dhe eshte e pjesshme dhe nuk i perfshin te gjitha pretendimet tona ne kerkesen per rishqyrtim 2-e. AK ne sqarim/pergjigjen e dhene thote se per implementim te projektit koha prej 30 dite konsiderohet e mjaftueshme, por nuk tregon me fakte se si arrihet implementimi per 30 dite, nuk tregon ndonje formule te kalkulimit se si kane arritur deri te koha e kerkuar per implementim. Nese AK nuk dote kishte per qellim favorizimin e nje Operatori Ekonomik, kohen e perafert per implementim te projektit do ta planifikone nga KUR te tjere te cilat tashme veqse kane implementuar sisteme te njejta per kohe mete gjate implementimi dhe me sasi mete madhe te stafit te angazhuar. Duke u bazuar ne pretendimet tona dhe pergjigje te AK, shihet qarte se pretendimi i jone qendron dhe bazohet ne matje dhe krahasime me pune veqse te realizuara ne KUR te tjere, ndersa AK vazhdon te favorizoj nje Operatorin Ekonomik i cili e posedon sistemin sipas kerkesave te AK dhe posedon ne stok pajisjet harduerike sipas kerkeses se AK.

Siq e kemi thene dhe ne kerkesen per rishqyrtim, Autoriteti kontraktues, ka perpiluar specifikime teknike qe favorizojne nje Operatore Ekonomik, duke kerkuar qe Moduli mobil offline i Lexuesve dhe Moduli windows app.offline i arkave statike te jete ne sq/ Lite databaze dhe te vendoset çmimi per njesi. Nje sistem te tille te zhvilluar ne sq/ Lite databaze e posedon vetem nje Operator Ekonomik dhe nje menyre e tille e prokurimin e demton rend buxhetin e AK-se pasi qe per çdo paisje shtesë,AK eshte I obliguar te paguaj edhe per instalim te softverve.
AK ne "pergjigjen' e dhene ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim per piken 2- f, thote:
Pretendimi eshte i pa bazuar sepse kodi burimor i SQL Lite eshte ne domenin publik dhe mund te perdoret gratis nga kushto per qfaredo qellimi gje qe nuk kufizon asnje OE ne perdorimin e tij (shih vegzen: https:l/www.sq/ite.prg/index.html). Vareferia ndaj llojllojshmerise se produkteve dhe mungesa e veglave nga OE i ben OE me inferior ndaj konkurences dhe nuk mund te sjel1 prova ose aludoj se AK favorizon dike ne treg

. "Pergjigja" e dhene e Autoriteti Kontraktues per pretendimin tone 2-f, nuk qendron dhe eshte e pjesshme, nuk e perfshin te gjitha pretendimet tona ne kerkesen per rishqyrtim 2-f dhe permes nje

pergjigje ofenduese mundohet ti jep konotacion tjeter. Askund ne kerkesen tone nuk kemi thene se AK do te paguaj per SQL Lite. Ne kemi thene edhe jemi te bindur se sistemin te cilin e ka kerkuar AK te zhvilluar ne SQL Lite e ka vetem nje Operator Ekonomik te cilin po e favorizon AK. Po ashtu kemi thene se AK po e demton buxhetin duke ja pershtatur dhe tabelen e çmimeve nje Operatori Ekonomik ashtu siq e ka te ndertuar sistemin, pra per njesi, konkretisht pika 2 dhe 5 ne tabele te çmimeve. AK do te paguaj per çdo instalim te softuerit (pika 2 dhe 5 ne tabel te çmimeve) nga 1-40 dhe do te paguaj shtese nese vendos te rrit numrin me shume se 40, pra kufizohet dhe do te jete i varur nga Operatori Ekonomik te cilin po e favorizon ne te ardhem.

Duke u bazuar sqarimet e dhena pas vendimit te AK dhe fakteve dhe provave te cilat gjenden ne kerkesen per rishqyrtim dhe vendimin e Autoriteti Kontraktues, kerkojme nga OSHP qe te obligoj Autoriteti Kontraktues qe beje anulimin e procedures se prokurimit dhe te perpiloje specifika teknike te qarta dhe afate te arritshme ne perputhje me legjislacionin ne fuqi duke mos favorizuar nje Operator Ekonomik

Demi material nga ky proces i prokurimit eshte rreth 2,000.00 Euro

KRITERET PËR VLERËSIM

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Per kete lend nuk ka raport te vlersimit sepse procedura vetem eshte shpallur dhe nuk jane hapur ofertat sepse OE- ankuese ka bere kerkes per ryshqyrtim dhe ankes ne OSHP- gjate fazes sa tenderi ka qene i hapur ende pa arrit afati per dorezim te ofertave.
(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertësë OE ankues /ofertave, por të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "**RENER"SHPK .** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja e sistemit ekzistues dhe implementimi i faturimit mobil ne terren"**, me nr.të prokurimit**: KRURGJA-22-3606-1-2-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:

"RENER"SHPK

Sqarimi i lëndës nga eksperti shqyrtues **Pergjigjeje e pretendtimet ankimore**
AK duhet te veproj sipas nenit 7 te LPP-së qe te mos favorizoj asnje OE dhe te diskriminoj nje OE tjeter ,po ashtu edhe neni 18.9 i RRUOPP qe thotë se dosje e tenderit duhet te pregatitet ne menyr qe Nuk -kufizon konkurencen mes OE-ve ose - Diskriminon kunder ose vepron ne favor te nje OE ose me shume OE-ve Pra AK- te kete parasysh mos-diskriminimin. AK te specifikimi teknik i detyrueshem te paraqes te dhena te nevojshme per projektin dhe te qarteson konform nenit 28 te LPP-se dhe pikes 20.4 te RrUOPP. AK-te vendos kodin burimor ne njoftim per kontrate dhe ne FDT. AK te bej korigjimin dhe te vazhdoj afatin e hapjes se ofertave Lenda te korigjohet dhe te zgjatet afati i hapjes (dorezimit te ofertave). Pretendimi ankimor eshte pjeserisht i bazaur.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues te OSHP-së qe ankesa te aprovohet pjeserisht e bazuar. Autoriteti Kontraktues te korrigjon kriteret dhe te respektohen dispozitat Ligjore te LPP-se dhe RrUOPP-se dhe te shtyhet afati per dorezim te ofertave.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**
- Panelit Shqyrtues: **OSHP-së**
- OE ankues: **"RENER"-SHPK.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "**RENER"SHPK .** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja e sistemit ekzistues dhe implementimi i faturimit mobil ne terren"**, me nr.të prokurimit**: KRURGJA-22-3606-1-2-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**